



Raport monitorues 15-të

**mbi punën e legjislativit të komunës së
Lipjanit**

Qershor 2017

Përmbajtja:

Hyrje,	Faqe 2
Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit	Faqe 3
Përmbledhje ekzekutive	Faqe 3
Dinamika e punës së Kuvendit	Faqe 6
Lista e raporteve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2017:	Faqe 6
Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë vitit 2017:	Faqe 7

Lista e tabelave:

Tabela 1: Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit gjatë 2015 - 2017	Faqe 6
Tabela 2. Fuqia e përfaqësimit të deputeteve i përkthyer në votë nga zgjedhjet lokale të vitit 2013:	Faqe 7

Lista e grafikoneve:

Grafiku 1. Përfaqësimi i burrave në asamblenë komunale në Lipjan sipas votave të fituara në zgjedhjet lokale 2013, duke përjashtuar bartësit e listës	Faqe 8
Grafiku 2. Përfaqësimi i grave në asamblenë komunale në Lipjan sipas votave të fituara në zgjedhjet lokale 2013	Faqe 8

Adresa: Rr."Tahir Sinani" 14000 Lipjan
Tel.:+377 (0) 44 786 414 & +386 (0)49 823 140
e-mail: info.yahr@gmail.com
Ueb faqja: <http://www.ngoyahr.weebly.com>
<http://www.yahr-monitorimi.weebly.com>
Facebook: <https://www.facebook.com/YAHR.Kosovo>

"Ky projekt u financua përmes grantit të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center"



Hyrje

Organizata Joqeveritare YAHR- do të vazhdojë me monitorimin e aktiviteteve të legjislativit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit ,gjatë periudhës katër vjeçare 2013/2017 dhe do të dal me raporte monitoruese- vlerësuese për çdo gjashtë muaj.

Youth Association for Human Rights /YAHR që nga vitit 2009 është duke bërë monitorimin pro aktiv të punës së kuvendit të Komunës së Lipjanit. Në monitorimin e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për periudhën gjashtë mujore, nëpërmes këtij raporti YAHR provon të kontribuoj në ofrimin e informacioneve të strukturuar të cilat do të jenë në shfrytëzim, para së gjithash për qytetarin e Komunës së Lipjanit, shoqërinë civile, mediat, si dhe vetë institucionin e monitoruar, Kuvendin e Komunës së Lipjanit.



Raporti të pesëmbëdhjete monitorues për punën e legjislativit të Kuvendit komunal të Lipjanit, karakterizohet me zhvillime në kundërshtim me interesat e qytetareve, ku kemi uzurpime dhe bojkote nga ana e përfaqësuesve të zgjedhur të qytetareve. Me gjithë atë YAHR-i është munduar që të hartojë një raport duke u mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimi i seancave të Kuvendeve Komunale, Komiteteve për Politikë dhe Financa, analizimit të dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rendet e ditës, analizimi i raporteve të medieve të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

Bekim Krasniqi

Drejtor ekzekutiv i YAHR-it

Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit

YAHR në tentativë për të adresuar interesat dhe brengat të qytetarëve në mënyrë të paanshme dhe apartiake u ofron qytetarëve informata në mënyrë të vazhdueshme. Synimi i monitorimit të punës së zyrtarëve të zgjedhur është ndërtimi i një shoqërie të qëndrueshme demokratike.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t’iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave.

Përmbledhje ekzekutive


Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit “Qeverisja Lokale në Lipjan” bazuar në monitorimin e punës së Kuvendit komunal të Komunës së Lipjan gjatë periudhës Janar – Qershor 2017. Monitorimi është fokusuar në Asamblenë Komunale dhe organet tjera të këtij Kuvendit.

Në bazë të punës sonë monitoruese të drejtpërdrejtë dhe në bazë të vlerësimeve me anë të fletë notimit kemi konstatuar këto fakte:

- ✓ Gjatë monitorimit të punës së Kuvendit komunal të periudhës së parë të vitit 2017 është karakterizuar me një gjendje të pazakontë, me bojkot nga ana opozitës dhe me uzurpim të postit të kryesuesit të kuvendit komunal në Lipjan.

Ndërprerja e mbledhjes së 38-të të Kuvendit Komunal në Lipjan me 01.03.2017, për shkak të mungesës së kuorumit si pasojë e bojkotit nga partitë opozitare dhe tentativa për mbajtjen e mbledhjes së 39-të pa u përfunduar mbledhja e 38-të, janë hapa që nuk janë në interes të qytetarëve. Organizata Joqeveritare YAHR si monitoruese e institucioneve lokale ka reagon ashpër për shkak të paralizimit të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, si pasojë e interesave të ngushta politike të liderëve partiak.

Kërkesa e partive opozitare për mbledhje të jashtëzakonshme është e drejtë legjitime dhe të cilën duhet procedohet, pa marrë parasysh a i pëlqeu a jo kryesuesit të Kuvendit Komunal të Komunës së Lipjanit. Kjo është e drejtë e përcaktuar në ligjin për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040 të datës 20 shkurt 2008. Ku në nenin 44.1, ku thuhet se: ***"Takimi i jashtëzakonshëm i kuvendit të komunës caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga, më së paku, një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës, apo me kërkesë të kryetarit"***. Dhe në bazë të Udhëzimit administrativ 02/2015 për mbajtjen e Mbledhjeve të kuvendit të komunës, kryesuesi është i obliguar që të thërret mbledhjen e Kuvendit komunal sipas kërkesës së anëtarëve të Kuvendit. Kjo është vërtetuar edhe me shkresën e dërguar nga MAPL-ja të datës 04.05.2017. Andaj mos thirrja e mbledhjes së jashtëzakonshme është shkelje ligjore nga ana e Kryesueses së kuvendit Komunal të Lipjanit Vlora Limani Hajnuni.



Megjithatë, pas presioni të vazhdueshëm kryesuesja e Kuvendit komunal të Lipjanit ka reflektuar pozitivisht dhe me 16 Qershor 2017 ka ftuar për seancën të jashtëzakonshme plenare, sipas kërkesës së 13 deputeteve komunal.

- ✓ Gjatë periudhës raportuese Janar – Qershor 2017, kuvendi komunal i Lipjanit ka mbajtur vetëm një mbledhje dhe një mbledhje të jashtëzakonshme, që do të thotë se nuk ka pasur ndonjë aktivitet tjetër. Ku gjatë kësaj mbledhje kemi pasur vetëm 4 vendime të miratuara dhe një raport dhe një informatë.
- ✓ Gjatë periudhës raportuese Janar – Qershor 2017 nuk kemi pasur mundësi që të bëjmë përzgjedhjen Top treshes me aktive dhe Top treshes më pasive nga ana e deputetëve , për shkak se nuk ka pasur

numër të mjaftueshëm të seancave plenare dhe është mbajtur vetëm një seancë të rregullt plenare dhe nuk është reale nëse bëhet një vlerësim vetëm me një seancë plenare.

- ✓ Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk kemi ndonjë një dinamikë të mirë të ngritjes së shqetësimeve të qytetareve nga ana e deputeteve, për shkak të ngërçit politike që ka ndodhur në Kuvendin Komunal, si pasojë e bojkotit të deputeteve opozitar.
- ✓ Të njëjtën gjendje e kemi edhe sa i përket pyetje parlamentare të drejtuar mbi punën e ekzekutivit.
- ✓ Vazhdohet me sëmundjen kronike që Komuna e Lipjanit vazhdon me shkeljen e Ligjit për Kufijtë Administrativë të Komunave Nr. 03/L-041 të datës 20 shkurt 2008, me anë të Statutit Komunal (Nr. .110-623 i datës 26.09.2008). Ku në bazë të këtij ligji, Komuna e Lipjanit i ka 59 vendbanime dhe fshatra, ndërsa në Statutin Komunal në kapitullin II, ku ka të bëjë me vendbanimet e komunës, gjegjësisht në nenin 13. rreth vendbanimet dhe fshatrat, figurojnë 70 vendbanime dhe fshatra, që do të thotë në bazë të ligjit të lartë përmendur Komuna e Lipjanit i ka 11 fshatra më pak se sa me statutin komunal.
- ✓ Vazhdohet me mos transparencë nga ana e Kryesueses së Kuvendit Komunal, me injorimin e dërgimit të materialeve të seancave të Kuvendit ndaj organizatave të shoqërisë civile dhe bëjnë seleksionimin se cilat janë të përshtatshme për të bashkëpunuar me ta.



Rekomandimet:

- ✓ Një qasje konstruktive të kryesuesit të organit të Kuvendit Komunal ndaj të zgjedhurve të qytetareve,
- ✓ Një përgjegjësi më të madhe të deputeteve ndaj interesave të qytetareve dhe të mos harrohet se ata janë aty për të përfaqësuar interesat e qytetarëve, e jo interesat individuale apo edhe partiake.
- ✓ Ofrimin e përgjigjeve nga ana e ekzekutivit ndaj pyetjeve të parashtruar nga ana e deputeteve komunal,
- ✓ Harmonizimi i Statutit Komunal me (Nr. .110-623 i datës 26.09.2008) dhe ligjet aktuale në fuqi të Republikës së Kosovës, gjegjësisht me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave Nr. 03/L-041 të datës 20 shkurt 2008.


- ✓ Një opozitë me e zëshme për artikullimin e interesave të qytetareve karshi ekzekutivit të Komunës së Lipjanit,
- ✓ Dërgimin e materiale të Kuvendit për organizatat monitoruese,
- ✓ Delegatet e Kuvendi i Komunës së Lipjanit duhen të jenë më aktivë dhe më efikas , e sidomos nëpër komitete.

Dinamika e punës së Kuvendit

Në këtë vit 2017 deri me tani janë mbajtur një seanca e rregull plenare dhe një e jashtëzakonshëm.. Ndërsa, po ashtu është mbajtur vetëm dy mbledhje të Komitetit për Politikë dhe financa. Nëse bëjmë një krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar është një gjendje jo e mirë e punës.

Tabela krahasuese 2: Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit gjatë 2015 - 2017

Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit								
Raporte të shqyrtuara			Rregullore dhe plane komunale të miratuara			Vendime komunale të miratuara		
2015	2016	2017	2015	2016	2017	2015	2016	2017
5	10	2	5	7	0	24	41	4



Lista e raporteve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2017:

- *Raporti i auditorit të pavarur për vitin 2015 të Kompanisë Regjionale të mbeturinave "Pastrimi" SH.A.*
- *Informatë për pastrimin e rrugëve nga bora.*

Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë vitit 2017:

- *Vendim për miratimin e Planit të veprimit për transparencë në Komunë*
- *Vendim për miratimin e planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit.*
- *Vendim për caktimin e lokacionit në Lipjan për rivendosjen e shtatores-bustit të veprimtarit të lëvizjes kombëtare Mulla Hamit Slllovisë.*
- *Vendim për përcaktimin e destinimit dhe shpalljen e konkursit për ndarjen e banesave në pronësi të komunës.*

Pyetjet parlamentare nga deputet gjatë periudhës raportuese:

Mbledhjes së 37-të:

Linda Sahihi: kërkoi që inspektorati të bënë një kontroll më të madhe në markete, si që tha ajo se në disa markete ka artikuj që u ka skaduar afati dhe ato u shitën konsumatorëve.

Ramiz Qeriqi: Theksoi se ka pasur shumë kërkesa të qytetarëve e gjithashtu edhe unë kam pasur kërkesa por përgjigje nuk kemi marrë. Unë shumë herë kam kërkuar që të bëhet kontrollimi i shtrimit i asfaltimit të rrugëve të cilat janë shtruar keq, e posaçërisht kam pasur vërejtje për asfaltimin e rrugës pas ABE-es e dëshiroj të dijë se a është kontrolluar kjo rrugë meqë pas shtrimit me asfalt në këtë rrugë ka dalur balta. Pastaj disa herë kam pyet për pranimin e rojës në shkollën e mesme se si janë pranuar, ato roje të sigurimit dhe kush i ka pranuar por nuk kam marrë përgjigje. Për shkollën në Grackë të Vjetër disa herë kam pasur kërkesë që në këtë shkollë të zhvillohet mësimi edhe në gjuhën shqipe dhe pyes se kjo shkollë a është në Republikën e Kosovës.

Pastaj tha se për rebelimin e nxënësve në shkollën e mesme në fund të vitit a janë marrë masa se Kryetari pat thënë se nuk janë të Lipjanit në bazë të videos që e kanë paraqitë.

Lulzim Rrustemi: Kërkoi që në mbledhjen e ardhshme të paraqitet një informatë për regjistrimin e pronave komunale meqë këtë punë e ka kryer një komision në bashkëpunim me DEMOS-in.

Pastaj ngriti çështjen e marrjes së pronave tek QMI nga shfrytëzuesit të cilët nuk i kanë kryer obligimet apo që nuk i kanë realizuar projektet e tyre. Andaj ngrit pyetjen se deri ku ka shkuar kjo procedurë dhe a janë të lira ato prona të cilat janë marrë për t'i vazhduar procedurat më tutje.

Pyetje tjetër ishte se lidhur një pronë që është afër tregut, e cila është premtua për dhënien në shfrytëzim të asaj prone për kategoritë e dalura nga lufta dhe pyetja ishte se deri ku kanë shkuar procedurat.

Hajrije Salihu: Kërkou që të përkrahet artistja Valentina Marevci për hapjen një ekspozitë nga Kryetari.


Blerim Gashi: kërkoi informata për arsim sidomos pas rezultateve që kanë dalë nga “PISA”.

Tabela 2. Fuqia e përfaqësimit të deputeteve i përkthyer në votë nga zgjedhjet lokale të vitit 2013:

	Deputeti	Subjekti Politik	Votat
1	FLORENT HOXHA	PDK	8,601 bartës i listës
2	PETRIT KELMENDI	PDK	567
3	LULZIM RRUSTEMI	PDK	326
4	NAZMI KRASNIQI	PDK	400
5	ENVER KOZHANI	PDK	398
6	FERIZ HASANI	PDK	387
7	ALI STUBLLA	PDK	362
8	VALBONA SHILLOVA	PDK	229
9	BURBUQE ILAZI	PDK	227
10	VLORA BUJA	PDK	191
11	LABINOT SHAHINI	LDK	7,434 bartës i listës
12	NEHAT TERPEZA	LDK	280
13	DAUT AZEMI	LDK	414
14	AGRON HAJDINI	LDK	400
15	ARTON RETKOCERI	LDK	327
16	NAIM JAHIRI	LDK	294
17	VLORA LIMANI-HAJNUNI	LDK	191
18	BURBUQE FAZLIU	LDK	180
19	LINDA SHAHINI	LDK	149
20	XHEVAT OLLURI	AAK-LDD-IQL	4,037 bartës i listës
21	RIZAH BAJRAKTARI	AAK-LDD-IQL	207
22	UKË KRYEZIU	AAK-LDD-IQL	166
23	MERITA ZEQRIRI-HAJRIZI	AAK-LDD-IQL	158
24	HAJRIJE SALIHU	AAK-LDD-IQL	181
25	ARBEN BAHTIRI	VETËVENDOSJE	1,494 bartës i listës
26	EDITA GASHI	VETËVENDOSJE	70
27	BLERIM GASHI	AKR	2,047 bartës i listës
28	ADELINA KRASNIQI	AKR	91
29	XHAVID MAHOLLI	PDK	432 bartës i listës
30	RAMIZ QIRIQI	PSD	243
31	ZORAN CIRKOVIC	G.I.SRPSKA	540 bartës i listës

Përfaqësimi i burrave në asamblenë komunale në Lipjan sipas votave të fituara në zgjedhjet lokale 2013, duke përfshirë bartësit e listës

1. PETRIT KELMENDI	PDK	567
2. DAUT AZEMI	LDK	414
3. NAZMI KRASNIQI	PDK	400
4. AGRON HAJDINI	LDK	400
5. ENVER KOZHANI	PDK	398
6. FERIZ HASANI	PDK	387
7. ALI STUBLLA	PDK	362
8. ARTON RETKOCERI	LDK	327
9. LULZIM RRUSTEMI	PDK	326
10. NAIM JAHIRI	LDK	294
11. NEHAT TERPEZA	LDK	280
12. RAMIZ QIRIQI	PSD	243
13. RIZAH BAJRAKTARI	AAK	207
14. UKË KRYEZIU	AAK	166



Përfaqësimi i grave në asamblenë komunale në Lipjan sipas votave të fituara në zgjedhjet lokale 2013

1 VALBONA SHILLOVA	PDK	229	vota
2 BURBUQE ILAZI	PDK	227	vota
3 VLORA BUJA	PDK	191	vota
4 VLORA LIMANI HAJNUNI	LDK	191	vota
5 HAJRIJE SALIHU	AAK-LDD	181	vota
6 BURBUQE FAZLIU	LDK	180	vota
7 MERITA ZEQRIRI-HAJRIZI	AAK-LDD	158	vota
8 LINDA SHAHINI	LDK	149	vota
9 ADELINA KRASNIQI	AKR	91	vota
10 EDITA GASHI	VETËVENDOSJE	70	vota



Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Janar – Qershor 2017.
2. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Janar –Qershor 2017
3. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit, Janar –Qershor 2017,.
4. Komunikatat për media të YAHR-it Janar –Qershor 2017.
5. Ekstraktet nga mbledhjet e Kuvendit Komunal , Janar –Qershor 2017,
6. <http://kk.rks-gov.net/lipjan/> .

